



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5 pika (ii), 15.1 pika (a), (c), (f), (j), 21.2, 78, 79 dhe 80 pika (a) të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, dt. 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Europiane të Aviacionit (më tej referuar si "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja e saj përkohshme në fuqi për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Me qëllim të implementimit të Rregullores (EC) Nr. 1070/2009 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian date 21 tetor 2009, e që amendon Rregulloret (EC) Nr. 549/2004, (EC) Nr. 550/2004, (EC) Nr. 551/2004 dhe (EC) Nr. 552/2004, brenda aktit nënligjorë të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 1/2016

PER PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr.8/2009, PËR VENDOSJEN E KORNIZËS PËR KRIJIMIN E QIELLIT TË VETËM EVROPIAN, RREGULLOREN Nr. 9/2009, PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR NË QIELLIN E VETËM EVROPIAN, RREGULLOREN Nr. 10/2009 PËR ORGANIZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRËS AJRORE NË QIELLIN E VETËM EVROPIAN, DHE RREGULLOREN Nr. 11/2009 PËR NDËRVEPRUESHMËRI TË RRJETIT TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR EVROPIAN

Neni 1

Rregullorja (EC) Nr. 1070/2009 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 21 tetor 2009, që amendon Rregulloret (EC) Nr. 549/2004, (EC) Nr. 550/2004, (EC) Nr. 551/2004 dhe (EC) Nr. 552/2004 shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e (EC) Nr. 1070/2009 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje si shtojcë dhe formon pjesën e saj përbërëse.

Neni 2

2.1 Dispozitat e neneve 1 deri 5, të Rregullores (EC) Nr. 1070/2009 janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

2.2 Rrjedhimisht, dispozitat e neneve 1 deri 5 të Rregullores (EC) Nr. 1070/2009, ndryshojnë dispozitat përkatëse të referuara në Rregulloret e AAC-së Nr.8/2009, Nr. 9/2009, Nr. 10/2009 dhe Nr. 11/2009 të cilat kanë futur brenda rendit juridik të Republikës së Kosovës, Rregulloret e Këshillit dhe Parlamentit Evropian (EC) Nr. 549/2004, Nr. 550/2004(EC), Nr. 551/2004 (EC) dhe Nr. 552/2004(EC).

2.3 Çdo dispozitë e amendamenteve të ardhshme të Rregullores (EC) Nr. 1070/2009, pas futjes së saj në Shtojcën I ose II të Marrëveshjes për HPEA, do të jetë e zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.

Neni 3

3.1 Kuptimi i shprehjeve dhe definicioneve të përdorura në këtë Rregullore është i përfshirë në Rregulloret e AAC-së Nr. 8/2009, Nr. 9/2009, Nr. 10/2009 dhe Nr. 11/2009.

3.2 Pavarësisht nga paragrafi 3.1 i këtij neni, shprehjet "Komuniteti", "ligji i Komunitetit", "legjislacioni i Komunitetit", "Instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "aeroporti i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Europiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "transportues ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", të cilat mund të referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në Rregulloret e AAC-së Nr. 8/2009, Nr. 9/2009, Nr. 10/2009 dhe Nr. 11/2009, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

Neni 4

Në rast të interpretimit të Rregullores (EC) Nr. 1070/2009, do të përdoret versioni original në gjuhën angleze, siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 shkurt 2016.

Prishtinë, 5 shkurt 2016

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm